



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1304/4 prot.

Tiranë, më 21.03.2018

VE N D I M

Nr. 18, Datë 21/03/2018

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT MBI “ZBATIMIN E
LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË DHE VLERËSIMIT TË
SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe nga kontrolli i cilësisë pas procedurës së ndjekur për rishikimin për cilësinë e auditimit, mbi vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit, vlerësoj se KLSH përgjatë vitit 2017 ka vijuar me veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me

rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit. Menaxhimi i ndryshimit dhe zhvillimit institucional është realizuar duke konsideruar implementimin e objektivave strategjike si një proces dinamik duke proceduar me rivlerësimin, përditësimin, përshtatur dhe zgjeruar dimensionet objektivave strategjike. Njëherazi është proceduar me sigurimin e monitorimit të planit strategjik si një proces, i cili mundëson përditësimin e objektivave duke i shtuar vlerë strategjisë për zhvillim institucional. Raportet e monitorimit kanë shërbyer edhe si një instrument informimi dhe transparence për palët e interesit si publiku, Kuvendi e Komisioni Evropian, dhe të gjitha organizmat ndërkombëtare të cilëve u mundësohet në këtë mënyrë vlerësimi i progresit të zhvillimit Institucional. Gjithsesi, konstatohen fusha ku ka nevojë për përmirësime të vogla.

Për sa më sipër dhe bazuar në nenet 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi “Zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësimin të sistemit të menaxhimit financiar”.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Sistemet e kontrollit të brendshëm janë funksionalë dhe garantojnë menaxhim e administrim të kujdesshëm të aktivitetit. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit përgjithësisht reflekton zbatimin e kërkesave ligjore. Deviacioni në rritje i buxhetit fillestar në vlerën 111.068,5 mijë lekë ose 19% rritje lidhet me investime të cilat nuk mund të parashikoheshin në buxhetin fillestar pasi ishin rrjedhojë e transferimit të Institucionit në Godinën e Re. Raportet financiare japin një pasqyrë të drejtë të transaksioneve dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2017.

A. MASAT ORGANIZATIVE

Gjetje 1: Nga auditimi rezultoi se në aktivet e qëndrueshme në vlerën e godinës ku Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtron aktivitetin e tij, me adresë Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë, është përfshirë vetëm vlera e rikonstruksionit të godinës, nuk është përfshirë vlera e objektit të mëparshëm.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, Sekretari i Përgjithshëm, të ngrejë një grup pune i cili bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe dokumentacionin e duhur teknik të kryejë rivlerësimin e aktiveve të qëndrueshme, godinën ku kryen aktivitetin.

Deri më 30.06.2018

Gjetje 2: Nga auditimi rezultoi se bazuar në Urdhrin e Kryetarit nr 165 datë 07.02. 2018 është ngritur komisioni për kryerjen e inventarit të Aktiveve, konform kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar . Procesi i inventarizimit pritet të kryhet gjatë vitit 2018, e për rrjedhojë nga grupi i auditimit nuk u bë i mundur krahasimi e rezultateve të inventarizimit me të dhënat që paraqet kontabiliteti. KLSH përgjatë fillim vitit 2018 u transferua në godinën e re për këtë arsye procesi i inventarizimit filloi në muajin Shkurt 2018.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Komisioni i inventarizimit dhe më pas ai i vlerësimit fizik të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, të materialeve në magazinë dhe të inventarit në përdorim të kryejë evidentimin e saktë të mallrave me qarkullim të ngadalshëm apo të aktiveve të cilat me transferimin në godinën e re dhe me investimet e kryera në drejtim të modernizimit të infrastrukturës rrjetit informatik dhe telefonik janë të panevojshme për tu përdorur, të propozojë masat përkatëse për evadimin e tyre nëpërmjet tjetërsimit, shitjes, transferimit në ente të tjera shtetërore si shkolla apo nxjerrjes jashtë përdorimit konform përcaktimit të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar

Menjëherë

Rekomandim për Sekretarin e Përgjithshëm të KLSH: Në mbështetje të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe UMF nr. 100, datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin

Publik”, për masat e marra sipas programeve të përgatitura nga ana juaj për zbatimin e rekomandimeve, të njoftohet Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Shënim:

Në rast se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, bazuar në kërkesën e përsëritur të Kontrollit të Lartë të Shtetit në 5-së vitet e fundit, nuk përcakton audituesit e jashtëm të cilët do të auditojnë veprimtarinë e KLSH-së brenda muajit maj 2018 atëherë ky auditim do të përsëritet nga një grup audituesish me përvojë në KLSH, në marrëdhënie pune ose që kanë plotësuar moshën dhe janë në pension.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R